



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më **15.03.2019** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni ti përvendos të gjithë të gjithë anëtarët e KKSBB, Nënkyetarët e komunës, Fatmir Iska, Drejtoret e Drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Osman Ismajli, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSBB-së, FSK-së, KFORIT, UNMIKUT, OSBES, përfaqësuesit e klerit fetar, shefin e ZKK-së z. Lendrit Qeli, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i dytë për vitin 2019 i KKSBB-së. Propozoj këtë rend dite:

REND DITE

- 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,**
 - Trotuaret, lirimi i tyre dhe shenjat sinjalizuese,
 - Qentë endacak,
 - Siguria ne Trafik,
 - Vetëdijesimi i qytetarëve dhe parandalimi i zjatreve,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
- 3. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane,**
- 4. Të Ndryshme.**

Kryetari - E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.

Kryetari – Vlerësimi ynë për gjendjen e përgjithshme në Komunën e Rahovecit është pozitiv, këtë e them nga të gjitha informacionet dhe të dhënat që ne i disponojmë si udhëheqje komunale. Gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën tonë është e qetë, stabile dhe e qëndrueshme, pavarësisht se gjatë kësaj periudhe ka mundur të ketë edhe sfida, por aspak këto nuk e cenojnë situatën e përgjithshme të komunës së Rahovecit. Komuna jonë këto ditë është ballafaquar me zjarre të shumta, por njësitë tona të zjarrfikësve në bashkëpunim me policin e Kosovës dhe inspektoratin e komunës, kanë pasur

angazhime të cilat kanë pasur për qëllim që të përballohet sfida e zjarreve, të cilat ishin bukur të shumta dhe të shpeshta. Ne kemi reaguar menjëherë sipas kërkesave, nevojave dhe shqetësimave të cilat janë paraqitur gjatë kësaj periudhe sa i takon zjarreve. Pastaj ne si komunë kemi pas edhe angazhime të tjera, ku për këtë një falënderim të veçantë i takon policisë së Kosovës, si dhe publikut të Komunës së Rahovecit. Në Rahovec ka qenë një ngjarje e cila ka zgjatur pesë ditë, pra me rastin e hapjes së palestrës së Rahovecit, po ashtu është mbajtur Final - 8 kupa e Basketbollit të Kosovës, dhe gjatë këtyre ditëve probleme serioze nuk ka pasur. Në këto ditë për përcjelljen e Final 8, në basketboll ka pasur të interesuar të shumtë nga të gjitha grupe moshat, po ashtu ato ditë ka pasur qytetarë edhe të komunave të tjera të Republikës së Kosovës të cilët kanë ardhur që të përcjellin lojën. Për këtë i përgëzozë, federatën e basketbollit, klubin e basketbollit, policin e Kosovës dhe të gjitha organet e tjera të cilat në mënyrë direkët apo indirekte kanë kontribuar që ta kapërcejmë këtë ngjarje të jashtëzakonshme. Ka pasur edhe plotë angazhime të cilat kanë të bëjnë me trajtimin e këtyre nënpikave të cilat edhe sot do i trajtojmë, natyrisht se këto do të mbesin angazhime të përhershme, ku secili prej nesh do të jepe kontributin e vetë. Komuna do të ketë peshën e vetë, policia detyrat dhe përgjegjësit e veta, pastaj ju si anëtar të KKSB-së, sigurisht se vazhdimisht do të kenë angazhime të cilat do i trajtojnë të gjitha pozicionet të cilat ndikojnë në klimën e përgjithshme të sigurisë në Komunën e Rahovecit. Qoftë me lirimin e hapësirave publike, shenjat sinjalizuese, pastaj qentë endacak, pastaj me sigurinë në trafik, pastaj me vetëdijesimin, parandalimin, angazhimin për parandalim të zjarreve sepse ne tani vetëm jemi në sezonin e pranverës dhe duhet të përballemi me këto situata etj. për më shumë rrëth kësaj pike do ja kalojë fjallën kapitenit z. Osman Ismajli.

Osman Ismajli – Përrshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, do raportoj për muajin janar dhe shkurtë të këtij viti. Situata e përgjithshme e sigurisë gjatë muajit janar dhe shkurtë 2019 në komunën e Rahovecit ka qenë e qetë dhe stabile, nuk kemi pasur prishje masive të rendit dhe qetësisë, ka qenë pa konflikte ndëretnike, këto dy muaj kanë qenë të ngarkuara me festa të ndryshme që nga viti i ri e këndej, përvjetorë të ndryshme, manifestime të ndryshme sportive etj.

Rendi dhe qetësia publike, janë raportuar gjatë këtyre dy muajve gjithsej 4 raste, ma karakteristik ka qenë rasti gjatë garave që janë zhvilluar në palestrën “Mizahir Isma” në Rahovec, ku është mbajtur Final – 8 kupa e Kosovës nga data 27.03.2019 deri me 03.03.2019, ku ka qenë një rrahje e izoluar dhe ne si polici kemi mare masa menjëherë për arsyet e madhe të pjesëmarries së publikut. Ne po ashtu ato dit kemi qenë në sprovë nga faktori ndërkombëtar, sepse ato ditë kanë mare pjesë 12 vëzhgues nga FIBA, mendoj se ne e kemi kaluar këtë sprovë në mënyrë të shkëlqyer. Mendoj se qytetarët e komunës së Rahovecit me të vërtet e kanë dhënë në provim me sjellje denjitoze, sepse diku rrëth 40 % e shikuesve kanë qenë femra dhe fëmijë. Mënoj se simpatizantët nga Mitrovica, Suhareka dhe Prishtina janë bindur se këtu ka rend dhe rregull dhe funksionon shteti ligjor. Të arrestuar kanë qenë 8 tifozë, 5 nga ta kanë qenë nga Suhareke dhe 3 prej tyre nga Rahovecit, ndaj tyre është iniciuar procedura penale për vepër penale lëndime të lehta trupore, por asnjëri nuk ka qenë në rrezik për jetë. Sipas statistikave tona kanë qenë mbi 12 mijë shikues në këto 5 ditë sa ka zgjatur Final-8 Kupa e Kosovës, dëme nuk ka pasur sa i përket sallës. Tani rinia e Komunës së Rahovecit e ka adresën e caktuar tek sala e sporteve, le të mirën ma shumë me sporte dhe le të hiqen nga kafiterit, po ashtu nga konsumimi i alkoolit, cigares dhe drogave.

Kriminaliteti – Gjatë kësaj periudhe kemi pasur një rrënje prej 4% të krimít krasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, zbulueshmëria e rasteve ka qenë 79% në muajin janar, kurse në muajin shkurtë 49%. Totali i rasteve të raportuara janë 73, zbulueshmëria është 85% në muajin janar kurse në muajin shkurtë 58%. Veprat penale më karakteristike në komunën tonë që janë raportuar dhe regjistruar për këto dy muaj janë: Lëndime trupore 7 raste, vjedhje dhe vjedhje të rënda gjithsej 13 raste, ku objekt sulmi vazhdimisht janë objektet e banimit si shtëpitë, banesat, pastaj veturat të parkuara nëpër qendrat tregtare etj, vrasje nuk kemi pasur, grabitje nuk kemi pasur. Dhuna në familje kemi gjithsej 4 raste, incident në shkolla kemi pasur vetëm një rast në shkollën e mesme “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe, ka pasur rrahje në mes nxënësve, ndaj 3 prej tyre zhvillohet procedurë penale lëndim i lehtë trupor, këtu kemi të bëjmë me disa nxënës që janë të transferuar nga shkolla e tjera, ne si polici ja kemi bërë një kërkesë Drejtorit të DKA-së, që të kenë kujdes në mënyrë që të padisiplinuarin të mos e dërgojnë

në një shkollë ku është disiplina në nivel, sepse me këtë jemi duke krijuar vatra të reja të problemeve, prandaj duhet të ju iket këtyre problemeve. Incidentet ku minoritetet janë viktimë apo paraqitës të rasteve, janë raportuar gjithsej 4 raste, një është rasti i dëmtimit të pllakës përmbi Hoçë të Madhe për këtë është zbuluar autori, kryesi i kësaj vepre nuk është nga komuna jonë. Sa i përket dukurive të zjarreve që janë duke ndodhur këto ditë në Komunën e Rahovecit, para vete e keni edhe raportin e Dreitorit për Mbrojtje dhe Shpëtim, kanë qenë mbi 40 zjarre ku kanë intervenuar zjarrfikësit, por ndezja e shtëpizës tek Epopeja e UÇK-së ka qenë rasti më i rëndë, këto tjera kanë të bëjmë kryesisht me zjarre nëpër fusha. Problemi i qenve endacak është ende në komunën tonë, por edhe në komunat e tjera të Republikës së Kosovës qëndron ky problem, ju ndoshta i keni vërejtur disa qen që i kanë disa kapëse në vesh, ata qen janë të trajtuar, por kompani e cila gjendet në Gjakovë pas trajtimit i lirojnë përsëri në vendin ku i kanë marrë, rreziku është permanent posaçërisht përfëmijët tanë gjatë udhëtimit të tyre në shkollë, po ashtu rreziku është edhe për kalimtarët e tjerë. Të ju them të drejtën nuk është gjetur një formulë adekuate as nga ne po as nga qeveria, ne si komunë nuk kemi as kapacitet që ti trajtojmë sepse trajtimi i tyre është i kushtueshmë deri në 80.00 € është trajtimi i një qeni. Komuna ka mundësi që të trajtojë vetëm disa raste ekstreme që paraqesin rrezik të madh, në raste kur është i sëmurë dhe shumë i rrezikshëm dhe ata pastaj e likuidojnë. Si çështje shqetësuese për ne dhe gjithë qytetarët mbetet komunikacioni rrugor, sipas statistikave në Kosovë nga komunikacioni rrugor mbesin të vdekur nga 110 – 130 persona, kurse numri i të lënduarve dhe të atyre që mbesin të pa aftë është nga 3000 – 5000 persona, kurse sa i përket dëmeve materiale është më mirë që mos të flasim sepse jemi dëshmitar të atyre që jemi duke i parë përfunduar. Situata në komunikacionin rrugor në komunën tonë është e volitshme por nuk ka vend përvetësuar, ne në komunën tonë nuk kemi pasur aksident me fatalitet gjatë këtyre dy muajve. Por ajo që duhet potencuar është parkimi i veturave nëpër trotuare si në qytet ashtu edhe në disa vendbanime të mëdha të komunës sonë, parkimi vend e pa vend si në derë të shkollës, pastaj në trotuare, para shtëpive dhe para dyqaneve, vështirësojnë qarkullimin edhe të veturave të tjera, por edhe të këmbësorëve. Pastaj përveç veturave tani si ka kaluar stina e dimrit tani disa kafiteri kanë filluar të i vendosin tavolinat nëpër trotuare, nuk e besoj se kanë leje nga komuna, pastaj ka filluar përsëri të bëhet ekspozimi i mallrave nëpër rrugë dhe trotuare, edhe pse rregullisht i kemi larguar këto në bashkëpunim me inspektoratin, mendoj se duhet të vazhdohet me shqiptimin e gjobave dhe konfiskimin e atyre mallrave. Sipas statistikave në trafik në komunën tonë, aksidente me fatalitet nuk kemi pasur, aksidente me lëndime përfunduar këto dy muaj i kemi pasur 9-të gjithsej, kurse me dëme materiale 21 aksidente, pra totali i aksidenteve është 30-të. Gjobat nga stacioni policor janë lëshuar 997, kurse nga trafiku rajonal i Gjakovës 699, gjithsej janë 1696 gjoba, mendoj se ky numër nuk është pak përfunduar. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve gjatë stinës së dimrit nga bora ka qenë në nivel, po ashtu edhe hedhje e kripës, përfunduar dua të i falënderoj kompanitë operuese. Pastaj çështje tjetër sa i përket policisë së Kosovës është ri ‘funksionalizimi i kamerave të cilat janë jashtë përdorimit përfunduar’ të instalimit të kabllave të rrymës elektrike, në pjesën e qytetit ku është edhe stacioni i policisë, ne duhet të i rikthejmë këto kabllo dhe të funksionalizohen kamerat. Hedhja e tonit se ai është faj, ky është faj, nuk është e mirë sepse fajtor jemi të gjithë, unë jam fajtor i parë që i kam lejuar që ti shkycin këto kamera.

Shaip Shala – Përshëndetje përfunduar gjithë tona pranishmit, e përgëzoj komandantin e stacionit policor në Rahovec z. Osman Ismajli përfunduar këtë raport të detajuar gjithashtu dhe inkurajuese është përfunduar se kemi rrënje të delikteve edhe nga viti i kaluar. Shfrytëzoj rastin edhe unë që të i falënderoj si përcjellës i kësaj kupe në basketboll, sa i përket mbarëvajtjes në basketball, ku rolin më të rëndësishëm e ka pasur policia e Kosovës dhe ne si Rahovecian i kemi përfunduar një mesazh edhe botës jo vetëm Kosovës, se Rahoveci dinë të organizojë. Po ashtu inkurajuese është fakti se edhe në trafik në komunën tonë nuk ka pasur aksidente me fatalitet. Kurse sa i përket pikës sa i përket informatës për zjarr vënie, kam një vërejtje konstruktive në përpilimin e informatës, ku në pesë fjali të para shkruan: “Përfunduar këtë kushtevë të thata të motit dhe ajrit”, sa e di unë kushtet e thata, nxehësia dhe vapa është në muajit gushtë dhe korrik, të kisha shkruar unë këtë si gazetar do të kisha mare kritika dhe vërejtje nga redaktori, por unë edhe këtë tema i kam trajtuar në atë kohë. Sa i përket këtyre zjarreve në këtë

ditë e di që fajtor kryesor është njeriu, por desha të di se sa sipërsaqe malore janë të përfshirë në zjarre, dhe sa janë dëme nëse i keni llogaritur.

Kryetari – Është e vërtet i nderuar sa i përket zjarr vënieve në këtë kohë mundet të jetë i qëllimshëm, por nuk mundem të pajtohem se si ka mundur dikujt të i shkojë në mendje të ja fusë zjarrin shtëpizës e cila është ndërtuar nga Komunës në bashkëpunim me komisionin evropian, kjo është vepër penale dhe shpresojmë se shumë shpejtë kryesit e këtij akti do të dalin para drejtësisë. Po ashtu është e njëjtë sikurse që ka elementë keqdashës të cilët nuk ja dëshirojnë të mirën popullatës së Hoçës së Madhe dhe as qytetarëve të komunës së Rahovecit, po ashtu as të Kosovës, prandaj tentojnë të fusin siç e thotë populli mish dhie në komunën tonë dhe të na e prish klimën e komunës sonë. Ne jemi jashtëzakonisht të përgatitur edhe si komunë, por edhe si polici, që ti zbardhim rastet e tillë, mendoj se do të zbardhet rasti se kush e ka ndezë atë shtëpizë dhe kush ka mundur të prekë ndonjë flamurë sikurse që e kanë hequr në Hoçë të Madhe këto ditë të fundit. Populli i Komunës së Rahovecit pavarësisht mendimeve, përkatësive rajonale, etnike kulturore dhe fetare nuk kanë probleme dhe nuk do të kenë, ka një normalitet në komunën tonë. Ne jemi të përgatitur që të japim zgjidhje gjithsecilit problem që na paraqitet, nëse dikush dëshiron ta sfidojë sigurinë e këtij vendi do të ketë përgjigje. Besoj se roli i KKSBB-së edhe në parandalimin e zjarreve edhe në lirimin e trotuareve dhe hapësirave publike do të ndikojë, policia së bashku me inspektoratin e komunës tanë do të veprojnë edhe në lirimin e lirimin e hapësirave publike, ata do të veprojnë si me gjoba mandatorë, ashtu edhe me gjoba në trafik. Ne nuk do të tolerojmë që pronat publike dikujt të i shkojë në mendje se mundet të i keqpërdor. Po ashtu kamerat e sigurisë në rrugë dhe ambientet e caktuara, në zonat e veçanta të cilat janë të ndjeshme, besoj se janë mekanizmat shtesë që i japin kuptimin përpjekjes sonë të përbashkët përforsimin e sigurisë. Ne me gjobat mandatorë vetëm kemi filluar këtë vit, pas shkrirjes së borës kanë dalë plotë probleme në sipërsaqe sepse ka tentative që të krijojnë deponi ilegale përsëri, janë duke harruar se ne duhet pastaj të harxhojmë mjete për ti larguar këto deponi, kurse ato mjete janë të qytetarëve nuk janë tonat. Ideja është që KKSBB-ja të jetë më aktive dhe me kontributë më konkrete në planin e ushtrimit të ndikimit ndërgjegjësimit, vetëdijesimit dhe sqarimit, përkitazi edhe me të drejtat dhe detyrimet që i kanë qytetarët, por edhe me vepritet operative që kanë me i ndërmarrë institucionet në partneritet, qoftë komuna me gjobat mandatore, qoftë policia, qoftë edhe organet e tjera. Qytetarët duhet të dinë se minden të dënohen prej 20-100 € vetëm pse e ka hedhur një qese me mbeturinë, qëllimi ynë nuk është që të i dënojmë sa më shumë njerëz, por qëllimi ynë është që të mirëmbahet sa ma mirë mjesidin dhe ambienti që na rrethon.

Hasan Përboqi – Përrshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Shaip Shala faleminderit për kritiken konstruktive, si Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim e pres një bashkëpunim shumë më të mirë nga KKSBB-ja, në mënyrë që mos të vije për periudhën që e kemi nga korriku e deri në shtator, ku do të paraqiten vatra ma të mëdha të zjarreve, pra mos të kemi kaq shumë zjarre. Përveç një bashkëpunimi të mirë që e kemi me policin e Kosovës, me sektorin e pylltarisë, pres bashkëpunim më të mirë edhe me qytetarët e Komunës së Rahovecit. Për çdo zjarrvënës të qëllimshme është mirë të raportohet tek organet përkatësse, pastaj organet përkatësse komfor ligjeve që janë në fuqi të ndërmarrim masa kundra keqbërësve. Do të ndalem tek kamp shtëpiza e cila është djegur, e ceku edhe komandanti dhe kryetari, mes natës së 6-7 marsit njësia e zjarrfikësve rreth orës 13:20 të natës ka pranuar një thirrje nga policia e Kosovës se ka një zjarr në një objekt tek Epopeje e UÇK-së. Njësia e zjarrfikësve ka dal menjëherë në vendin e ngjarjes por përfat të keq njësia e zjarrfikësve nuk ka mundur me e lokalizu zjarrin, kësaj i ka ndihmuar edhe materiali i objektit që ka qenë i ndërtuar nga druri. I bëjmë thirrje organeve kompetente që të bëjnë zbardhjen e këtij rasti sa më shpejtë që është e mundur, dhe kryesit e këtij rasti dhe rasteve të tjera të dënohen. I nderuari z. Shapi Shala, sa i përket zjarreve malore ne së bashku me sektorin e pylltarisë që është në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë jemi duke punuar Raportin final se sa hektar ose sa sipërsaqe të pyjeve janë djegur.

Osman Ismajli - Vepra penale kemi tri sa i përket zjarreve një është vikendica në mal dhe rasti tjetër është trekëndëshi në mes Malishevës, Rahovecit dhe Suharekës, sipas raportit janë 3 ha përsëri i madh përpos vikendicës, raste janë të hapura nën hetime, ndërsa këto zjarre tjetër intervenohen nga zjarrfikësit që të eliminojnë rrezikun që mos të ketë përhapje të

lokalizohen dhe të parandalohen menjëherë. Nëse e bëjmë kahasimin e dëmit të Viva Fresh-it në Gjakovë kjo tek ne është vetëm një lugë ujë në det.

Kryetari – Në pikën e dytë të rendit të ditës do ti jap disa përfundimi në bazë të rezultatit që kemi biseduar. Faleminderit shumë për kontributin komandantit të policisë z. Osman Ismajli dhe të gjithë që debatuani rreth këtyre çështjeve që janë paraparë për këtë rend dite sipas planit vjetor të KKSBB-së. Ne brenda këtij muaji marrim tri kamion të zjarrfikësve, njësia është funksionale dhe pajiset me mjete shtesë dhe jemi të përgatitur për këtë sezon. I lus të gjithë anëtarë të KKSBB-së, njësisë së policisë të gjithë njerëzve që ja dojë të mirën këtij vendi, pyjeve, maleve që i çmojnë vlerat e këtij vendi që të angazhohen maksimalisht në hetimet e rasteve të zjarrvënësve ku ka perceptim që janë të qëllimshme. Djegia e pyjeve, zhveshja e këtyre zonave kodrinor malore mos harroni që ndikon në klimë dhe plotë aspekte tjera që lidhen me reshje, vërvime të cilat e rendojnë jetën e qytetarëve. Ne jemi të interesuar që të vazhdojmë projektin e pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura në bashkëpunim me institutin bujqësor në Pejë dhe drejtoren e bujqësisë në komunën e Rahovecit por ka dhe donator që i kushtojnë rëndësi pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura. Ne kemi ndërmarr disa veprime sa i përket sinjalizimeve, nuk janë të mjaftueshme, por do të mundo hemi që të konkretizojmë me sinjalistikë më të mirë të rrugëve dhe rrugicave tona, kemi punuar rreth ndriçimit publikë nëpër shumë zona dhe vazhdojmë ta bëjmë në parandalimin e keq dhe të keqbërësve, kemi plane në sinjalizim kontrata do të riaktivizohet ku do të rrisim punën tonë të konkretizojmë si për shenja të komunikacionit, tabela e tjera kemi akoma nevojë që ti kushtojmë kujdes shenjëzimit sidomos rrugëve kryesore. Sa i përket qeneve endacak përgjegjësia e komunave të Republikës së Kosovës është minimale e veprimit në këtë drejtim, por me pas të drejtë nga AVUK-u, ministria e bujqësisë ose ministria e linjës me bashkëpunim me komunën efikasiteti i trajtimeve të qeneve endacak do të ishte më i lartë, sidoqoftë është përgjegjësi e AVUK-ut i cili i ka ndërmarr disa veprime ku sigurisht do të vazhdoj edhe këtë vit sepse ka shumë qen endacak që i sjellin nga komuna tjera. Situata e trajtimit të qeneve endacak besoj që është mjaftë serioze sepse kemi një rast kafshimi në fshatin Pastasel për fat të mirë ai qen ishte i trajtuar ku jemi përkujdesur nga ana e mjekësisë ku gjithçka është në rregull, nuk do të doja që të përballemi me situata të tilla edhe pse mjekësia është e avancuar. Këtë problem do të adresojmë në institucione përkatëse, është një projekt që ne do të sjellim disa gypa të llamarinës që do ti vendosim nëpër rrugë ku këto do të shërbejnë për ushqimin e qeneve, ushqimin do ta marrim përsipër ne pastaj këta qen nuk janë më të rrezikshëm. Kemi edhe plane tjera si ndriçimi publik, trotuare, zgjerimin e rrugëve, mbrojtje të mjedisit, për intervenime emergjente, kemi aksione e kam njoftuar KKSBB-n që pozita e inspektorëve nga ky muaj është forcuar dhe janë angazhuar me punë shtesë ku operojnë 7 ditë të javës ku qytetar duhet te jenë të informuar se nuk ka vend për punë të pa ligjshme, ndryshe do të përgjigjen edhe inspektor para ligjit për mos veprim, pesha dhe roli i inspektorëve po rritet, intensiteti i veprimit tarisë së tyre po rritet nga ky muaj bukur disa gjoba mandatorë ku do të jenë në aksion të përditshëm, siç do të jenë në bashkëpunim me policin për lirimin e trotuareve dhe hapësirave publike. Tani e kemi një parking shtesë në shfrytëzim për makina derisa të merret në menaxhim nga një projekt, kërkesa jonë është që të informohen qytetarë sa më shumë kemi vend të mjaftueshëm për parking që të mos gjobiten ose të konfiskohen makinat ku paguhet edhe kostoja e shërbimeve dhe veprimeve që i bëjnë organet tjera, nuk është mirë ne si KKSBB që të tolerojmë para syve tanë me mos veprimin tonë që të përballemi me një situatë tragjike, prandaj porosia dhe kërkesa jonë është që të informojmë sa ma shumë qytetar të jenë të vetëdijshëm ku mund të veprojnë dhe ku jo përndryshe shteti jonë ka mekanizma të mjaftueshëm me veprime të veta mund të gjobisë ose të ndëshkoj secilin që tenton të bëj veprime të jashtëligjshme, po ashtu kamerat e sigurisë janë aktivizuar, mirëmbajtja e ambientit dhe mjedisit është në fokusin tonë, pra qytetar mund të gjobiten për mos respektim të ligjit ne kemi filluar me konfiskim të mallit të atyre që janë në kundërshtim me ligjin pasi nuk posedon leje për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike. Nuk do të lejojmë që të rrezikohetjeta e 15 mijë qytetarëve në qytetin e Rahovecit, nuk është dëshira jonë që të qëndroj malli dhe djersa e dikujt në depo tona, por do të qëndrojmë dhe do të veprojmë në mënyrë energjike që mos të tolerojmë do të konfiskojmë mallin nëse nuk veprojnë me kriterë do të arrestohen sepse kanë kapacitet dhe komuna lëshon leje për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirës publike ose drejtoria e shërbimeve publike aq sa i duhet por jo të

keqpërdorin rrugën. Ne do të jemi serioz dhe energjik e di që edhe anëtar të KKSBB-së janë të dedikuar edhe në bazë të funksioneve dhe fuqive që të jepin kontribut në planin e informimit, sqarimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve tanë për të drejtat, detyrimet që kanë qytetar dhe institacione tona në parandalimin e çfarëdo veprimit që cenon sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit. Ju falënderoj për vëmendjen kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Organizimi i takimit publik me qytetar dhe kryetar të fshatrave dhe lagjeve urbane

Kryetari – Ne do të organizojmë një debat publik dhe nga muaji prill kryetari i komunës me ekip do të shkoj në çdo lagje dhe lokalitet të komunës së Rahovecit për të diskutuar për të gjitha çështje që kanë të bëjnë me vitin 2019 dhe plane për vitin 2020, por para këtij takimi do të takohemi me kryetar të lagjeve urbane, qyteteve dhe kryetar të këshillit të fshatrave këtu dhe do ti dorëzojmë orarin e aktiviteteve komunale ose diskutimeve të hapura që do të ndodhin gjatë muajit prill çdo lokalitet të komunës së Rahovecit. Përse e bëjmë këtë? E para është në planin e veprimit dhe ishte ideja e OSBE-së por edhe për faktin që ne duhet të informojmë më shumë zyrtarisht qytetar tanë për ofertën e komunës së Rahovecit. Çfarë oferte ka dhe çfarë mund të bëjmë ne me sugjerimin, vërejte dhe plotësime që mund ti bëjnë qytetarët në mënyrë që të përgatitemi gjithnjë e më mirë për vitin 2020. Sa ma mirë që të informohen qytetarët çoftë përmes këshillit të fshatrave, kryetarëve, asamblistëve, apo ekzekutivit jo rastësisht është futur në rend të ditës kjo pikë dhe organizimi publik me qytetar sepse këto janë mekanizma që ndikojnë në sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit. Duhet ti informojmë njerëzit e pa informuar që mos të kemi situata konfuze, pra detyra jonë imediate është që ndërmjet të gjitha mekanizmave të futet në lojë edhe ekzekutivi i komunës, komandant i policisë dhe KKSBB-ja përmes diskutimit publik, dëgjimit publik dhe asaj që thonë qytetar ne të kemi mundësi të shpalosim informacione të dobishme të cilat ata nuk mund ti dinë.

4. Të ndryshme

Nysret Abazibra – Përshendetje për të gjithë, dua të ngrisë dy çështje vitin e kaluar kemi diskutuar për dy dukuri që janë mjaftë sfiduese dhe të dëmshme çështja e lojërave të fatit dhe përdorimi i drogës. Kam një kërkesë për në takimin e rrallës ta kemi një konstatim të gjendjes së lokaleve të lojërave të fatit. Sa janë në komunën e Rahovecit dhe lokacioni i tyre, sa operojnë në mënyrë të jashtëligjshme? Dukuria e dytë është nëse ka ndonjë institucion përgjegjës ose statistikë për përdoruesit të drogës që si komunë të dimë numrin e përdoruesve që ne si KKSBB të organizojmë një fushat të vetëdijesimit të këtyre dy dukurive veçanërisht duke i dedikuar moshës së këtyre përdoruesve sidomos gjenerata e shkollës së mesme është ajo më e prekura, pra të ketë një aktivitet në emër të këtij këshilli do të ishte e dobishme që edhe ne të ndërmarrim disa takime nëpër shkolla, takime me të rinj dhe kjo çështje të trajtohet në emrin tonë.

Kryetari – Komandanti i policisë përgatitet për takimin e rrallës sepse do të jetë në rend të ditës edhe pse është në plan të zbatimit por nuk është specifiku. Sa i përket çështjes së lojërave të fatit unë kam kërkuar nga drejtori i inspektoratit kisha dashur këtu të tregoj se çfarë ka ndërmarr edhe pse nuk është kompetencë e jona por e ministrisë së tregtisë dhe industrisë sepse janë të pajisur me licenca. Jam i informuar se disa aksione janë ndërmarr por ishin proceduara të komplikuara unë se bashku me inspektor nën shoqërimin e policisë së paku ato që janë të jashtëligjshme të myllen, ndërsa ata që janë të ligjshme kompetent janë ATK-ja, dogana dhe mekanizma të tjera. Ne duhet të tregojmë seriozitet në punën që do të bëjmë por nuk dua që veprime të jenë të jashtëligjshme. Sa i përket drogës, alkoolit policia i ka planet e zbatimit shpresoj që në takimin e rrallës do të informohemi më shumë rrëth këtyre rasteve.

Shani Hoti – përfaqësues i KLSP – së sektori 3. Sa për informatë ne jemi formuar në vitin 2017 kemi lajme pozitive që nga ai vite kemi arritur të térheqim dy projekte me ndihmën e OSBE-së, projektit i parë është realizuar në shkollën “4 Dëshmorët” tek këndi i lojërave. Projekt tjetër është fusha e sportit në Çifllak nën mbështetjen e juaj 15% ky projekt është pranuar dhe vazhdojnë procedura për implementimin e tij, njëkohësisht jemi falënderues të gjithë aktorëve për kontributin e tyre sepse vlera e gjithë këtij projektit arrin shumë prej 9.500 euro. Me moton “kushtet e mira dhe mirëqenia ndikojnë pozitivisht në sigurinë dhe në jetën e qytetarit”.

Kryetari – unë si kryetari i komunës dhe si anëtar të KKSBB-së do të ishte mirë të tërheqim ndonjë projekt në të mirën e komunës së Rahovecit, me anë të kësaj do ti tregonim qytetarëve se KKSBB-ja është funksionale. Lufta jonë e përditshme është që ti minimizojmë këto probleme me masa preventive, me plane konkrete, por edhe të prodhojmë lajme të mira sepse kemi mundësi me anë të projekteve në bashkëpunim me policin, shkollave, minoritetet pra të fokusohemi në veprimitari tjera për të mirën e këtij vendi.


Lulzim Krasniqi – unë vetëm desha që të ëmbëlsoj takimin e sotëm pasi që vazhdimisht po dëgjojmë kritika, problematika të ndryshme të jetës, përgëzoj angazhimin e pedagogeve dhe psikologëve komunal që kanë për të destinuar rininë, nënshkrimin e marrëveshjes me CARITAS KOSOVA për shërbime mjekësore në shtëpi dhe implementimin e iniciativës që e keni marr për shndërrimin e ambientit të parkut të qytetit kjo është një iniciativë shumë e mirë dhe rrëthimin e shkollës së mesme Xhelal Hajda – Toni.

Kryetari – Do të angazhohen 5 psikolog dhe pedagog bashkë me DKA-në besoj që do të prodhojnë efekte pozitive në rritjen e sigurisë nëpër shkolla, në parandalimin e plotë situatave në të cilat ndodhen sepse është moshë e ndjeshme dhe ata do të kenë debate, trajnime ku do të kemi plotë mundësi për veprime që deri sot në mungesë të pedagogëve dhe psikologëve i kemi pasur, nënshkrimin e marrëveshjes me CARITAS KOSOVA neve na shton mundësit siç e dini sivjet edhe 25 mjekë e infermier na ka lejuar ministria e financave, do të kemi mundësi që brenda muajit qershor do të kemi punë me 3 ndërrime në Krushë dhe Ratkoc 24h shërbim do të ketë, në Drenoc, Fortesë, Opterushë, Çifllakë do të punojnë 2 ndrime do të zgjatet koha e shërbimeve shëndetësore të qytetarëve. Sa i përket rrithojës së shkollës do të kryet së shpejti pas shumë mundi se jo gjithçka varet nga ne. Po përpinqemi të jemi më efikas dhe mbikëqyrja të jetë me e rreptë dhe kontrata të zbatohet dhe të përmbushet sa ma mirë me ligjin. A ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e deklaroj të myllur këtë takim shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

Procesmbajtësi

Skendr Hamza



Kryetari i Komunës

Smajl Latifi